



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Envinion" Sh.P.K. të datës 04.04.2023 kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 30.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dizajnimi i identitetit të ri të kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-22-12339-2-2-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 138 222, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Envinion" Sh.P.K. të datës 04.04.2023 kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 30.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dizajnimi i identitetit të ri të kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-22-12339-2-2-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 138 222.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Envinion" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Envinion" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 30.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dizajnimi i identitetit të ri të kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-22-12339-2-2-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 138 222.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. **Pretendimi i parë** - *“Pa pasur asnjë ankesë apo kërkesë për rishqyrtim, të paktën jo përmes platformës së e-Prokurimit, Autoriteti Kontraktues Komunale e Prishtinës, me datë 30.03.2023 ka publikuar sërish Njoftim të Ri mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka ndryshuar rezultatin e vlerësimit të aplikacioneve dhe ofertën e Envinion Sh.P.K. nuk e ka kualifikuar”.*
- II. **Pretendimi i dytë** - *“Rivlerësimi i ofertave nuk është në përputhje me ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit - Autoriteti Kontraktues, pas përfundimit të vlerësimit të aplikacioneve në përputhje me Nenin 47 të Rregullave të Prokurimit Publik, dhe pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së në platformën e e-Prokurimit, në rast se nuk ka ndonjë kërkesë për rishqyrtim, duhet që menjëherë në përputhje me Nenin 50 të Ligjit të Prokurimit Publik të dërgoj Ftesat për tenderim tek operatorët ekonomik të para-kualifikuar. Pra Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik Neni 50 dhe Rregullave të Prokurimit Publik Neni 47 ... Duke parë Njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 10.02.2023, vërehet se vetëm gjashtë operator ekonomik janë kualifikuar, që do të thotë se nuk ka pasur asnjë arsye për Autoritetin kontraktues për të rivlerësuar ofertat e operatorëve ekonomik....”.*
- III. **Pretendimi i tretë** - *“Vlerësimi i aplikacioneve nuk mund të bëhet mbi bazën e kontratave të përfunduara ... që do të thotë se vlerësimi nuk është bërë në përputhje me Nenin 47 të Rregullave të Prokurimit Publik... Në rastin përkatës autoriteti kontraktues duhet që vlerësimin ta bëjë mbi bazën e këtyre kritereve, por jo duke u bazuar në kontratat e përfunduara, pasi që referencat mund të jenë vetëm element kualifikues (i llojit kalon, nuk kalon) por jo edhe kriter me të cilin poentohet një operator më shumë sesa një tjetër”.*

Duke u referuar te pretendimi i tij, parashtruesi ka kërkuar nga autoriteti kontraktues që të miratoj në tërësi si të bazuar kërkesën për rishqyrtim ashtu që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim të fazës së parë si dhe të përfshihet parashtruesi si tenderues i kualifikuar për fazën e dytë të aktivitetit të prokurimit.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 33, 50, dhe 52 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si “LPP”).

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë dhe dokumenti i parakualifikimit i datës 04.11.2022;
- Procesverbali i hapjes së aplikacioneve i datës 25.11.2022;
- Raporti i vlerësimit të aplikacioneve lista e ngushtë e datës 29.12.2022;
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 10.03.2023;
- Kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Re-Publika Marketing & Media Solutions” Sh.P.K të datës 15.03.2023;
- Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim i datës 20.03.2023;

- Raporti i rivlerësimit të aplikacioneve lista e ngushtë e datës 22.03.2023;
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim i datës 30.03.2023;

Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 06.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet pretendimi i parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”) sipas elaborimeve në vijim.

Lidhur me pretendimin e parë: nga administrimi i provave materiale është gjetur se me datë 15.03.2023 operatori ekonomik Re-Publika Marketing & Media Solutions”Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në përputhje me nenin 60 *et.al.* të RRPP. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe me datë 20.03.2023 është marrë vendim përmes të cilit është miratuar si e bazuar në tërësi kjo kërkesë për rishqyrtim ashtu që është autorizuar autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të kthej në rivlerësim aktivitetin përkatës të prokurimit si dhe është anuluar B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 10.03.2023. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit se “nuk ka pasur ankesë apo kërkesë për rishqyrtim” nuk qëndron. Për këtë arsye pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë: fillimisht duhet cekur se pretendimi i dytë i parashtruesit është i ndërlidhur ngushtë me pretendimin e parë i cili në këtë rast prezantohet si parakusht për të vërtetuar ose jo pretendimin e dytë. Kjo konfirmohet sidomos kur parashtruesi në kuadër të pretendimit të dytë potencon “*në rast se nuk ka ndonjë kërkesë për rishqyrtim*” si dhe kur potencon se “*nuk ka pasur asnjë arsye për Autoritetin kontraktues për të rivlerësuar ofertat*”. Duke u referuar te elaborimi lidhur me pretendimin e parë, është konfirmuar pa mëdyshje se ka pasur kërkesë për rishqyrtim për të cilën është vendosur me vendim nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Njëkohësisht të dy këto dokumente janë administruar si prova materiale për të vendosur mbi kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit. Prandaj jo vetëm që ka pasur arsye për rivlerësimin e ofertave por kjo arsye ka buruar pikërisht nga neni 47 paragrafi 47.17 që e citon edhe vet parashtruesi në pretendimin e dytë dhe ku përcaktohet se “*Nëse numri i kandidatëve të përshtatshëm që plotësojnë kushtet e përzgjedhjes është më i madh se maksimumi prej gjashtë (6), pikat e forta dhe dobësitë relative të aplikacioneve të këtyre kandidatëve duhet të ri-shqyrtohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderimit*”. Prandaj vendimi i datës 20.03.2023 për miratimi i kërkesë për rishqyrtim të datës 15.03.2023 të cilat i mohon se ekzistojnë parashtruesi, kanë konsistuar në rritjen e numrit të kandidatëve të përshtatshëm në më shumë se gjashtë (6). Rrjedhimisht rivlerësimi në këtë rast është bërë i domosdoshëm në kuptim të nenit 47 par. 47.17 të RRPP. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit se nuk ka pasur arsye që të rivlerësohen ofertat sepse nuk janë plotësuar kushtet nga neni 47 par. 47.17 të RRPP, nuk qëndron. Për këtë arsye pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë: fillimisht duhet cekur se sipas nenit 47 par. 47.17 të RRPP përcaktohet se *“Gjatë rishqyrtimit, Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë për rishqyrtim vetëm faktorët e publikuar në Njoftimin e Kontratës. Autoriteti Kontraktues mund të merr parasysh vetëm kriteret e kapacitetit financiar ose teknik si kritere shtesë”*. Pikërisht këtë dispozitë e ka cituar edhe vet parashtruesi në kuadër të pretendimit të tretë. Sidoqoftë nga interpretimi gjuhësor i kësaj dispozite rezulton se me rastin e rishqyrtimit duhet të merren parasysh faktorët e publikuar në njoftimin për kontratë. Ndërsa si kritere shtesë mund të shfrytëzohen vetëm kriteret e kapacitetit financiar ose teknik. Prandaj me qëllim të shqyrtimit të këtij pretendimi është administruar si prova materiale njoftimi për kontratë së bashku me dokumentin e parakualifikimit të datës 04.11.2022, raporti i vlerësimit të aplikacioneve lista e ngushtë e datës 29.12.2022 si dhe raporti i rivlerësimit të aplikacioneve lista e ngushtë e datës 22.03.2023. Me këtë rast është gjetur se në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale rubrika 8.1&8.2. në Dokumentin e Parakualifikimit lidhur me Kapacitetin teknik dhe profesional është kërkuar dëshmia si në vijim *“Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve”*. Kjo kërkesë si e tillë është evidentuar edhe sipas njoftimit për kontratë rubrika III.2.4. lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Në këtë mënyrë është gjetur se nuk qëndron pretendimi i parashtruesit se nuk mund të bëhet vlerësimi i ofertave mbi bazën e kontratave të realizuara sepse ky kriter nuk ka qenë i përcaktuar me njoftimin për kontratë dhe dokumentin e parakualifikimit siç kërkohet me nenin 47 par. 47.17 të RRPP. Për këtë arsye pretendimi i tretë i parashtruesit është i pabazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Rrjedhimisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është gjetur se të gjitha pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 4 nga 4

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net